



Komisioneri për Mbrojtjen  
nga Diskriminimi

Commissioner for Protection  
from Discrimination

## **RAPORT MONITORIMI**

**MBI STATUSIN E ZBATIMIT TË DETYRIMEVE PËR MIRATIMIN E**

# **AKTEVE NËNLIGJORE DHE DOKUMENTEVE STRATEGJIKE QË BUROJNË NGA LIGJI NR. 64/2025 “PËR BARAZINË GJINORE”**



## PASQYRA E LËNDËS

|                                                                                                                              |   |
|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|---|
| KUADRI LIGJOR DHE ROLI I KMD-SË .....                                                                                        | 3 |
| QËLLIMI I MONITORIMIT .....                                                                                                  | 3 |
| OBJEKTI I MONITORIMIT .....                                                                                                  | 4 |
| METODOLOGJIA E MONITORIMIT .....                                                                                             | 4 |
| GJETJET E MONITORIMIT .....                                                                                                  | 5 |
| Gjetja 1   Paketa e akteve nënligjore të parashikuara nga Ligji nr. 64/2025 nuk është miratuar në tërësinë e saj.            | 5 |
| Gjetja 2   Afati ligjor për miratimin e akteve zbatuese ka përfunduar .....                                                  | 5 |
| Gjetja 3   Përmbushja e disa detyrimeve ligjore varet nga koordinimi efektiv ndërinstitutional .....                         | 6 |
| Gjetja 4   Informacioni i administruar krijon bazë të mjaftueshme për monitorimin e vijueshmërisë të zbatimit të ligjit..... | 6 |
| NDIKIMI I VONESAVE NË ZBATIM.....                                                                                            | 7 |
| PËRFUNDIME.....                                                                                                              | 7 |
| REKOMANDIME.....                                                                                                             | 8 |
| VIJIMI I MONITORIMIT .....                                                                                                   | 8 |
| ANEKSI 1.....                                                                                                                | 9 |

## KUADRI LIGJOR DHE ROLI I KMD-SË

Ligji nr. 64/2025 “Për Barazinë Gjinore” synon garantimin, mbrojtjen dhe promovimin e barazisë gjinore në jetën publike dhe private. Neni 14 i këtij ligji e përfshin KMD-në ndër autoritetet përgjegjëse për përmirësimin dhe arritjen e barazisë gjinore, ndërsa neni 16 u kërkon institucioneve të pavarura rol proaktiv në zbatimin e kuadrit ligjor dhe të politikave publike, në përputhje me kompetencat e tyre. Në këtë kuadër, neni 32, pika 1, shkronja “dh”, i ligjit nr. 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, i njeh Komisionerit kompetencën për të monitoruar zbatimin e ligjit për barazinë gjinore.

Në ushtrim të këtij mandati, monitorimi i përmbushjes së detyrimeve që burojnë nga ligji nr. 64/2025, përfshirë miratimin e akteve zbatuese të parashikuara prej tij, përbën një pjesë të rëndësishme të veprimtarisë së KMD-së. Ky monitorim synon të vlerësojë ecurinë e institucioneve përgjegjëse në përmbushjen e detyrimeve ligjore, të evidentojë problematikat ose vonesat në proces dhe, kur është e nevojshme, të mundësojë formulimin e rekomandimeve për marrjen e masave të nevojshme për zbatimin efektiv të ligjit dhe garantimin e standardeve të barazisë gjinore.

## QËLLIMI I MONITORIMIT

Në ushtrim të kompetencave të tij ligjore, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka nisur procesin e monitorimit dhe vlerësimit të ecurisë së zbatimit të detyrimeve për miratimin e akteve nënligjore dhe dokumenteve strategjike të parashikuara nga ligji nr. 64/2025 “Për Barazinë Gjinore”.

Qëllimi i këtij monitorimi është vlerësimi objektiv dhe i bazuar në evidencë i ecurisë së përmbushjes së detyrimeve ligjore për miratimin e akteve nënligjore dhe dokumenteve strategjike të parashikuara nga ligji nr. 64/2025. Këto akte dhe dokumente përbëjnë një element të domosdoshëm për zbatimin efektiv të parashikimeve të ligjit në praktikë. Në këtë kuadër, monitorimi synon gjithashtu të vlerësojë respektimin e afateve të përcaktuara në nenin 51<sup>1</sup>, të ligjit, si dhe të evidentojë ecurinë e institucioneve përgjegjëse në përmbushjen e detyrimeve të tyre.

<sup>1</sup> Në aneksin 1 të këtij raportimi gjendet “Tabela përmbledhëse e dispozitave të Ligjit nr. 64/2025 që kërkojnë nxjerrjen e akteve nënligjore”.

## OBJEKTI I MONITORIMIT

Objekti i këtij monitorimi përfshin identifikimin e akteve nënligjore të kërkuara nga neni 51 i Ligjit nr. 64/2025 “Për Barazinë Gjinore”, përcaktimin e institucioneve përgjegjëse dhe të afatit ligjor, administrimin e informacionit mbi fazën e hartimit dhe miratimit, evidentimin e statusit të secilit detyrim dhe formulimin e rekomandimeve për vijimin e procesit.

Në këtë kuadër, monitorimi nuk kufizohet në evidentimin e statusit formal të akteve, por synon të vlerësojë masat e ndërmarra nga institucionet përgjegjëse dhe të kontribuojë në adresimin e rekomandimeve, në përputhje me kompetencat ligjore të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

## METODOLOGJIA E MONITORIMIT

Monitorimi u realizua përmes shqyrtimit të detyrimeve të parashikuara në Ligjin nr. 64/2025 “Për Barazinë Gjinore”, me fokus të veçantë në nenin 51, i cili përcakton aktet zbatuese që duhet të miratohen, autoritetet përgjegjëse dhe afatin për nxjerrjen e tyre. Në këtë kuadër, u identifikuan dispozitat që kërkojnë miratimin e akteve nënligjore ose ndërmarrjen e masave të tjera zbatuese dhe u evidentuan institucionet përgjegjëse për përmbushjen e këtyre detyrimeve.

Në vijim, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi iu drejtua institucioneve përgjegjëse me kërkesa zyrtare për informacion, me qëllim evidentimin e statusit të zbatimit të detyrimeve përkatëse. Kërkesat u fokusuan në aktet e miratuara, projektaktet e përgatitura, fazën procedurale në të cilën ndodheshin aktet ende të pamiratuara, si dhe në ecurinë e dokumenteve strategjike të lidhura me zbatimin e ligjit.

Në kuadër të kësaj faze të monitorimit u administruan përgjigjet zyrtare të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale dhe Ministrisë së Ekonomisë dhe Inovacionit. Informacioni i përcjellë nga këto institucione u shqyrtua në raport me kërkesat konkrete të ligjit, duke verifikuar për secilin detyrim aktin e parashikuar, autoritetin përgjegjës, afatin ligjor dhe statusin e raportuar të hartimit ose miratimit të tij.

Vlerësimi është mbështetur në informacionin zyrtar të administruar deri në momentin e hartimit të raportit. Në këtë fazë, monitorimi nuk synon të vlerësojë zbatimin material të të gjitha dispozitave të Ligjit nr. 64/2025 në praktikë, por të evidentojë nëse është krijuar kuadri nënligjor dhe institucional i parashikuar nga ligji dhe në çfarë faze ndodhet përmbushja e detyrimeve përkatëse.

Mbi këtë bazë, aktet dhe masat e monitoruara janë vlerësuar sipas statusit të tyre në momentin e administrimit të informacionit, duke dalluar detyrimet e përmbushura nga ato që vijnë në fazën e hartimit, konsultimit, bashkërendimit ose miratimit. Ky vlerësim përbën bazën për gjetjet dhe rekomandimet e paraqitura në këtë raport, si dhe për ndjekjen e mëtejshme të detyrimeve që rezultojnë ende të papërfunduara.

## GJETJET E MONITORIMIT

Nga verifikimi i të dhënave Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstaton se pjesa më e madhe e akteve zbatuese dhe e dokumenteve strategjike nuk janë miratuar brenda afatit 6-mujor, duke krijuar kushte të tejkalimit të afatit ligjor. Më poshtë renditen gjetjet kryesore të monitorimit, me përcaktimin e statusit aktual të detyrimeve që burojnë nga Ligji 64/2025 dhe vonesave të konstatuara.

### Gjetja 1 | Paketa e akteve nënligjore të parashikuara nga Ligji nr. 64/2025 nuk është miratuar në tërësinë e saj

Informacioni i administruar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale (MSHMS) dhe Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit tregon se institucionet përgjegjëse kanë ndërmarrë veprime për zbatimin e nenit 51 të Ligjit nr. 64/2025 “Për Barazinë Gjinore”. Konkretisht, urdhrat e Kryeministrit janë miratuar, ndërsa projektvendimet e Këshillit të Ministrave dhe udhëzimi i përbashkët ndërinstitutional vijnë në fazën e hartimit dhe të procedurave të miratimit. Po ashtu, dokumenti strategjik për barazinë gjinore është ende në proces përgatitjeje.

Për rrjedhojë, paketa e plotë e akteve zbatuese dhe dokumenteve strategjike të parashikuara nga ligji nuk rezulton ende e përfunduar. Megjithëse ligji ka hyrë në fuqi dhe dispozitat që janë të plota dhe të vetëzbatueshme vijnë të prodhojnë efektet e tyre juridike, dispozitat që kërkojnë nxjerrjen e akteve nënligjore për përcaktimin e procedurave, rregullave ose mekanizmave të zbatimit nuk mund të zbatohen në mënyrë të plotë deri në miratimin e këtyre akteve. Për këtë arsye, përfundimi i paketës së akteve zbatuese mbetet një kusht i rëndësishëm për zbatimin e plotë dhe efektiv të Ligjit nr. 64/2025.

### Gjetja 2 | Afati ligjor për miratimin e akteve zbatuese ka përfunduar

Neni 51 i Ligjit nr. 64/2025 “Për Barazinë Gjinore” parashikon një afat gjashtëmujor për miratimin e akteve nënligjore dhe dokumenteve strategjike të nevojshme për zbatimin e tij. Ky afat përbën një detyrim ligjor për institucionet përgjegjëse dhe synon të sigurojë krijimin, brenda një kohe të arsyeshme, të instrumenteve të nevojshme për zbatimin e plotë dhe të njëtrajtshëm të ligjit.

Monitorimi evidentoi se, megjithëse institucionet përgjegjëse kanë ndërmarrë veprime për hartimin e akteve, afati ligjor ka përfunduar pa u miratuar të gjitha aktet zbatuese të parashikuara nga ligji. Fakti që disa projektakte ndodhen ende në proces hartimi, konsultimi ose miratimi nuk ndryshon konstatimin se detyrimi ligjor nuk është përmbushur brenda afatit të përcaktuar nga ligjvënësi.

Mosrespektimi i këtij afati nuk cenon vlefshmërinë apo fuqinë juridike të Ligjit nr. 64/2025, i cili mbetet në fuqi dhe i detyrueshëm për zbatim. Megjithatë, vonesa në miratimin e akteve zbatuese ndikon në plotësimin e kuadrit rregullator të nevojshëm për zbatimin efektiv të ligjit, veçanërisht në ato fusha ku vetë ligji parashikon se procedurat, mekanizmat ose rregullat konkrete do të përcaktohen me akte nënligjore. Si pasojë, mund të krijohen vështirësi në zbatimin e njëtrajtshëm të dispozitave të ligjit dhe në funksionimin e plotë të mekanizmave që ai parashikon.

### Gjetja 3 | Përmbushja e disa detyrimeve ligjore varet nga koordinimi efektiv ndërinstitutional

Monitorimi evidentoi se një pjesë e akteve zbatuese të parashikuara nga Ligji nr. 64/2025 kërkojnë bashkëpunimin e disa institucioneve përgjegjëse, veçanërisht në fushën e statistikave gjinore, politikave të punësimit dhe adresimit të punës së papaguar. Në këto raste, përmbushja në kohë e detyrimeve ligjore varet jo vetëm nga veprimet e secilit institucion, por edhe nga koordinimi ndërmjet tyre gjatë hartimit, konsultimit dhe miratimit të akteve.

Megjithëse koordinimi ndërinstitutional është i domosdoshëm për cilësinë dhe koherencën e akteve, ai nuk e zëvendëson përgjegjësinë ligjore të secilit institucion për përmbushjen e detyrimeve që i ngarkon ligji. Për këtë arsye, është e rëndësishme që procesi të mbështetet në një planifikim të qartë, ndarje të përgjegjësisë dhe afate të mirëpërcaktuara. Në këtë kuadër, funksionimi efektiv i Këshillit Kombëtar për Barazinë Gjinore merr një rol të rëndësishëm si mekanizëm koordinues për ndjekjen e zbatimit të ligjit dhe harmonizimin e veprimeve ndërinstitutionale.

### Gjetja 4 | Informacioni i administruar krijon bazë të mjaftueshme për monitorimin e vijueshmërisë të zbatimit të ligjit

Informacioni i administruar nga institucionet përgjegjëse mundëson krijimin e një pasqyre të qartë mbi statusin e përmbushjes së detyrimeve të parashikuara nga neni 51 i Ligjit nr. 64/2025, duke dalluar aktet e miratuara nga ato që vijnë në proces. Ky informacion përbën bazën për vijimin e monitorimit institucional nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

Në fazën pasuese, monitorimi do të fokusohet jo vetëm në përfundimin e procesit të miratimit të akteve zbatuese dhe dokumenteve strategjike, por edhe në vlerësimin e zbatimit të tyre në praktikë, me qëllim evidentimin e efektivitetit të mekanizmave të krijuar dhe ndikimit të tyre në garantimin e barazisë gjinore dhe mbrojtjen nga diskriminimi.

## NDIKIMI I VONESAVE NË ZBATIM

Përmbushja në kohë e detyrimeve për miratimin e akteve nënligjore lidhet jo vetëm me zbatimin efektiv të Ligjit nr. 64/2025 “Për Barazinë Gjinore”, por edhe me angazhimet e Republikës së Shqipërisë në fushën e barazisë gjinore dhe mosdiskriminimit. Këto angazhime burojnë, ndër të tjera, nga Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave (CEDAW), Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe Protokolli nr. 12 i saj, si dhe Konventa e Këshillit të Evropës për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje (Konventa e Stambollit).

Njëkohësisht, në kuadër të procesit të integritetit evropian, zbatimi efektiv i kuadrit ligjor për barazinë gjinore lidhet me përafrimin dhe zbatimin e standardeve të Bashkimit Evropian për barazinë gjinore dhe trajtimin e barabartë. Në këtë kontekst, vonesat në miratimin e akteve zbatuese mund të ndikojnë në funksionalizimin në kohë të mekanizmave të parashikuar nga ligji dhe për rrjedhojë, në zbatimin efektiv të standardeve të barazisë dhe mosdiskriminimit.

## PËRFUNDIME

Monitorimi i zhvilluar nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi evidenton se institucionet përgjegjëse kanë ndërmarrë hapa konkretë për zbatimin e nenit 51 të Ligjit nr. 64/2025 “Për Barazinë Gjinore”, duke miratuar një pjesë të akteve të parashikuara dhe duke vijuar punën për hartimin e akteve të tjera zbatuese dhe të dokumentit strategjik për barazinë gjinore. Megjithatë, në përfundim të afatit gjashtëmujor të përcaktuar nga ligji, procesi nuk rezulton ende i përmbyllur.

Mosmiratimi i të gjitha akteve zbatuese brenda afatit ligjor nuk cenon vlefshmërinë e Ligjit nr. 64/2025, por lë të papërfunduar paketën e instrumenteve të nevojshme për zbatimin e plotë dhe të njëtrajtshëm të tij. Për pasojë, dispozitat që kërkojnë rregullim të mëtejshëm me akte nënligjore nuk mund të zbatohen deri në miratimin e këtyre akteve.

Komisioneri vlerëson se përfundimi sa më i shpejtë i procesit të hartimit dhe miratimit të akteve zbatuese mbetet i domosdoshëm për garantimin e sigurisë juridike, krijimin e praktikave të unifikuara të zbatimit dhe funksionimin efektiv të mekanizmave të parashikuar nga ligji. Njëkohësisht, përfundimi i këtij procesi do të kontribuojë në përmbushjen e angazhimeve të Republikës së Shqipërisë në fushën e barazisë gjinore dhe mbrojtjes nga diskriminimi.

Monitorimi evidenton se përfundimi i procesit të miratimit të akteve zbatuese përbën vetëm fazën e parë të zbatimit të Ligjit nr. 64/2025 “Për Barazinë Gjinore”. Efektiviteti i tij do të varet nga mënyra se si institucionet përgjegjëse do të organizojnë zbatimin në praktikë, do të koordinojnë veprimet ndërmjet tyre dhe do të ndjekin përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga ligji.

Në këtë kuadër, është e rëndësishme që institucionet përgjegjëse të sigurojnë mekanizma të qartë koordinimi, raportimi dhe ndjekjeje të zbatimit të ligjit, me qëllim garantimin e një zbatimi të njëtrajtshëm, identifikimin në kohë të vështirësive dhe marrjen e masave korrigjuese kur është e nevojshme. Një qasje e tillë do të kontribuojë në rritjen e efektivitetit të ligjit dhe në realizimin e objektivave të tij për garantimin e barazisë gjinore dhe mbrojtjen nga diskriminimi.

Në ushtrim të mandatit të tij ligjor, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi do të vijojë monitorimin e zbatimit të Ligjit nr. 64/2025, duke ndjekur jo vetëm përfundimin e procesit të miratimit të akteve zbatuese, por edhe mënyrën e zbatimit të tyre në praktikë dhe ndikimin e tyre në garantimin efektiv të barazisë gjinore, trajtimit të barabartë dhe mbrojtjes nga diskriminimi.

## REKOMANDIME

Në përfundim të këtij monitorimi, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi rekomandon:

|                                                                                  |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                        |
|----------------------------------------------------------------------------------|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| <b>PËRFUNDIMI I KUADRIT NËNLIGJOR</b>                                            | Këshilli i Ministrave dhe ministritë përgjegjëse, secili sipas kompetencave të përcaktuara në nenin 51 të Ligjit nr. 64/2025, të marrin masat e nevojshme për përfundimin, pa vonesa të mëtejshme, të proceseve për hartimin dhe miratimin e akteve nënligjore të parashikuara nga ligji.                                                                                                              |
| <b>INFORMIM PERIODIK MBI STATUSIN E AKTEVE NË PROCES</b>                         | Ministria përgjegjëse për çështjet e barazisë gjinore, në cilësinë e institucionit përgjegjës për koordinimin e zbatimit të Ligjit nr. 64/2025, të informojë periodikisht çdo 2 muaj Komisionerin për Mbrojtjen nga Diskriminimi mbi ecurinë e hartimit dhe miratimit të akteve ende në proces, si dhe mbi masat e ndërmarra për përfundimin e tyre.                                                   |
| <b>KONSULTIMI I PROJEKTAKTEVE ME KOMISIONERIN PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI</b> | Projektaktet nënligjore që rregullojnë çështje të lidhura me barazinë gjinore, trajtimin e barabartë dhe mbrojtjen nga diskriminimi t'i përcillen Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi për mendim gjatë procesit të hartimit, përpara miratimit të tyre, me qëllim vlerësimin e përputhshmërisë me standardet kushtetuese, ligjore dhe ndërkombëtare në fushën e barazisë dhe mosdiskriminimit. |

## VIJIMI I MONITORIMIT

Pas përfundimit të kësaj faze, monitorimi do të vijojë me vlerësimin e zbatimit të Ligjit nr. 64/2025 në praktikë. Faza pasuese do të përqendrohet në mënyrën se si autoritetet përgjegjëse përmbushin detyrimet e përcaktuara nga ligji dhe nëse masat e ndërmarra sigurojnë zbatimin efektiv të standardeve të barazisë gjinore dhe mosdiskriminimit.

*Shënim: Objekti dhe metodologjia e këtij monitorimi do të përcaktohen në funksion të detyrimeve konkrete të institucioneve dhe të informacionit të nevojshëm për vlerësimin e zbatimit të ligjit.*



## ANEKSI 1

Tabela përmbledhëse e dispozitave të Ligjit nr. 64/2025 që kërkojnë nxjerrjen e akteve nënligjore

| DISPOZITA          | OBJEKTI I AKTIT<br>NËNLIGJOR                                                                                                                                                                                                    | LLOJI I<br>AKTIT                    | AUTORITETI<br>PËRGJEGJËS                                                                                                                | STATUSI<br>AKTUAL                                 |
|--------------------|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-------------------------------------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|---------------------------------------------------|
| Neni 10,<br>pika 4 | Rregullat për përdorimin e<br>gjuhës me ndjeshmëri gjinore.                                                                                                                                                                     | VKM                                 | Këshilli i Ministrave                                                                                                                   | ● NË PROCES                                       |
| Neni 11,<br>pika 2 | Përmbajtja, procedura dhe<br>formulari tip i vlerësimit të<br>ndikimit gjinor.                                                                                                                                                  | VKM                                 | Këshilli i Ministrave                                                                                                                   | ● NË PROCES                                       |
| Neni 13,<br>pika 5 | Organizimi dhe funksionimi i<br>Grupit Ndërinstitucional të<br>Statistikave Gjinore.                                                                                                                                            | Urdhër i<br>Kryeministrit           | Kryeministri                                                                                                                            | ● MIRATUAR<br>– Urdhri nr. 83,<br>datë 29.04.2026 |
| Neni 18,<br>pika 7 | Rregullorja e organizimit dhe<br>funksionimit të Këshillit<br>Kombëtar të Barazisë<br>Gjinore.                                                                                                                                  | VKM                                 | Këshilli i Ministrave                                                                                                                   | ● NË PROCES                                       |
| Neni 20,<br>pika 2 | Mënyra e bashkëpunimit të<br>subjekteve publike/private me<br>ministrinë përgjegjëse për<br>shkëmbimin e informacionit.                                                                                                         | Nuk<br>përcaktohet<br>lloji i aktit | Ministri përgjegjës<br>për çështjet e barazisë<br>gjinore dhe subjektet<br>publike në nivel<br>qendror e vendor e<br>subjektet private. | ● NË PROCES                                       |
| Neni 28,<br>pika 4 | Mënyrat, format dhe fushat<br>konkrete të bashkëpunimit në<br>fushën e punës dhe të<br>punësimit ndërmjet<br>institucioneve në varësi të<br>ministrisë që mbulon çështjet<br>e punës e të punësimit dhe<br>ministrive të tjera. | VKM                                 | Këshilli i Ministrave                                                                                                                   | ● NË PROCES                                       |
| Neni 32,<br>pika 8 | Përmbajtja dhe masat që<br>duhet të merren nga subjektet<br>publike dhe private për të<br>adresuar punën e papaguar.                                                                                                            | Udhëzim i<br>përbashkët             | Ministri përgjegjës<br>për çështjet e barazisë<br>gjinore dhe punën;                                                                    | ● NË PROCES                                       |